



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 34 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 3 të Rregullores komunale nr.prot.01-016/01-0058139/22 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës të datës 15 korrik 2022, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 29 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, *pas rishqyrtimit sipas Shkresës së Ministrisë së Pushtetit Lokal nr.020-1019/8 datë 01.12.2022 për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit*, në mbledhjen e mbajtur më 09 dhjetor 2022, mori këtë,

VENDIM

FORMIMI I KOMISIONIT PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJES SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

1. Për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës, formohet komisioni, në këtë përbërje:

- 1.1. **Ardi Hasani**, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-LVV
- 1.2. **Ekrem Rrahmani**, anëtare nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK
- 1.3. **Mimoza Abdullahu**, anëtare nga radhët e Kuvendit të Komunës-PDK
- 1.4. **Burim Hasani**, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-AAK
- 1.5. **Antoneta Ejupi**, anëtare nga radhët e Ekzekutivit të Komunës
- 1.6. **Bleona Rama**, anëtare nga radhët e Shoqërisë civile
- 1.7. Anëtar/e përfaqësues nga këshilli i fshatit, vendbanimit, lagjes urbane, i cili propozohet dhe zgjedhet me shumicë të votave nga të pranishmit në tubimin zgjedhor të Këshillit përkatës.

2. Në aspektin teknik, administrativ dhe profesional, Komisioni Bashkëpunon me nëpunësin civil – Koordinatorin për bashkëpunim me këshillat lokale.

3. Kryesuesi i Komisionit, rregullat dhe mbarëvajtja e punëve dhe takimeve caktohen në takimin e parë të Komisionit, i cili ftohet nga Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, vepron konform Rregullores nr.prot.01-016/01-0058139/22 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi, si dhe i njëjti obligohet t'i raportoj Kuvendit të Komunës rreth rrjedhës së tubimeve, zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe çështje tjera relevante që ndërlidhen me këtë proces, pasi të ketë përfunduar i tërë aktiviteti si dhe pas çdo aktiviteti eventual që mund të paraqitet brenda mandatit.

Neni 3

Komisioni formohet në kohëzgjatje të njëjtë me mandatin e Kuvendit të Komunës, brenda të cilit i njëjti mund të plotësohet dhe ndryshohet me vendim të Kuvendit.

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtorja e Administratës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, ndërsa anulohet vendimi nr.prot.01-020/04-0093836/22 i miratuar nga Kuvendi i Komunës më datë 07 nëntor 2022.

Nr.prot. 01-020/04-0101084/22
Podujevë, datë; 09 dhjetor 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha